

Date of 23.04.2019			
Indeksi orig.	Numeri	Nr ekzempl	Vlera
001	765	2	



**MEMORANDUM MIRËKUPITIMI DHE BASHKËPUNIMI
NË MES TË
UNIVERSITETIT TË MITROVICËS "ISA BOLETINI"
DHE
S.T.A (COUNTRY MASTER DISTRIBUTOR FOR ETS)**

S.T.A (Country Master Distributor for ETS) dhe Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini", të referuar së bashku këtu si "Partnerët", përmes këtij Memorandumi të Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi pajtohen që të krijojnë partneritetin për testim të gjuhës angleze, përkatësisht 2 variantet e testeve, **TOEFL ITP®** dhe **TOEIC® L&R** dhe për Gjuhen Frënge, përkatësisht testi **TFI™**, të kandidatëve të interesuar për programet e studimit të ciklit të dytë dhe tretë, sipas Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 03/2018 për gjuhët e huaja në programin e studimit të ciklit të dytë apo të tretë.

Kohëzgjatja e këtij memorandumi është: / 04/ 2019 deri / 04 /2023, me mundësi vazhdimi.

Qëllimi

S.T.A (Country Master Distributor for ETS), si qendër zyrtare dhe e autorizuar ndërkombëtarisht për administrimin dhe testim të gjuhës angleze, përkatësisht 2 variantet e testeve, **TOEFL ITP®** dhe **TOEIC® L&R** dhe për Gjuhen Frënge, përkatësisht testi **TFI™**, do të ofrojë ndihmë dhe informata për testimin e njohurive të gjuhës së huaj - gjuhës angleze - përkatësisht 2 variantet e testeve, **TOEFL ITP®** dhe **TOEIC® L&R** dhe për Gjuhen Frënge, përkatësisht testi **TFI™**, për kandidatët që janë të interesuar për programe të studimit të ciklit të dytë dhe/ose tretë në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini", siç kërkohet në Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr.03/2018 për gjuhët e huaja në programin e studimit të ciklit të dytë apo të tretë dhe Dohet midis ETS Global dhe MASHT (date 04/12/2018 Pika 1 Intent)

S.T.A (Country Master Distributor for ETS), me numër identifikues - **810173899** si qendër testuese për testim në Kosovë është e themeluar nga data 07/11/2018 dhe selia e saj është në Prishtinë, në ambientet ish American School of Kosovo

Secili Partner ka obligime dhe përgjegjësi specifike sipas kushteve të kësaj Marrëveshje të

Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit.

1. Bazuar në nenin 3, pika 3.1. të Udhëzimit Administrativ të lartpërmendur, Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" dhe **S.T.A (Country Master Distributor for ETS)** arrijnë marrëveshje me qëllim të shkëmbimit të informacionit dhe të dhënave ndërkombëtare, për të gjithë kandidatët që aplikojnë në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini", për programet e studimit të ciklit të dytë ose të tretë.
2. Kandidatët, që janë të interesuar për programe të studimit të ciklit të dytë dhe/ose tretë në Universitetin e Mitrovicës, si dhe shprehin interesim për testim standardizues dhe ndërkombëtar të gjuhës angleze, t'i nënshtrohen testit të gjuhës angleze përkatësisht 2 variantet e testeve, **TOEFL ITP[®] dhe TOEIC[®] L&R** dhe për Gjuhën Frënge, përkatësisht testi **TFI[™]** tek qendra testuese **S.T.A (Country Master Distributor for ETS)**, në: <https://sta-edu.com/registration/>
3. Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" obligohet që informatën lidhur me marrëveshjen e arritur, të shpall në faqen zyrtare dhe në ambientet e tij.
4. Pas nënshkrimit të memorandumit certifikon UM si **Authorized Test Center for ETS tests.**



Mosrespektimi i Marrëveshjes

Palët nënshkruese të kësaj marrëveshje kanë të drejtë që të rivlerësojnë marrëveshjen nëse ndonjë pjesë e saj nuk është respektuar.

Nënshkrimet

Palët si më poshtë kanë ekzekutuar këtë Marrëveshje me 23.04, 2019

Për **S.T.A**
(Country Master Distributor for ETS)

Ines Dika

Përfaqësuese e përhershme

Për
Universitetin e Mitrovicës
"Isa Boletini"


Prof. dr. Alush Musaj

Rektor